

**NËSE I NDJENI SIMPTOMAT E
SËMUNDJES GJATË FLUTURIMIT,
LAJMËROHENI EKUIPAZHIN DHE
NJOFTONI PËR ITINERARIN E
UDHËTIMIT TUAJ!**

**Nëse gjatë 14 ditëve pas kthimit në
vend nga Kina ose nga vendet tjera
ku është regjistruar epidemi e
kësaj sëmundjeje, ju nuk ndjeheni
mirë, keni temperaturë të lartë të
trupit, kolliteni ose keni vështirësi
në frymëmarrje, kontaktoni me
qendrat ose njësitë rajonale më
pranë jush e që do i gjeni në faqen e
fundit të këtij materiali!
Informoni mjekun për gjendjen tuaj
shëndetësore dhe për udhëtimin që
keni bërë!**

**Shëndeti juaj dhe u
njerëzve pranë jush
varet nga informimi
dhe mirëmbajtja e
higjienës personale
dhe kolektive!**

Numrat e telefonave:

QSHP Manastir – 071261330
QSHP Veles – 071 219 278
NJR Gjevgjeli – 078 545 444
QSHP Koçan – 071 373 913
QSHP Kumanovë – 070 215 851
QSHP Ohër – 070 723 029
QSHP Prilep – 076 475 747
QSHP Shkup – 071 289 614
QSHP Strumicë – 072 235 543
QSHP Tetovë – 075 240 464
NJR Gostivar – 076 365 161
QSHP Shtip – 078 365 613
ISHP Shkup – 078 387 194
ShSh Alo Doktor – 02/15 123



**Instituti i
shëndetit publik**

i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Институт за јавно здравје на Република Северна Македонија

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Institut for Public Health of the Republic of North Macedonia
50-ta Divizija 6, 1000 Skopje
Tel: +{389} 02-3125 044
Fax: +{389} 02-3223 354
www.iph.mk



**Instituti i
shëndetit publik**

i Republikës së Maqedonisë së Veriut

INFORMACION PËR POPULLATËN

Janar, 2020

Novel Coronavirus
(2019-nCoV)

**REKOMANDIME
PËR UDHËTARËT**



Fakte kryesore:

Novel Coronavirus (2019-nCoV) është shkaktar i infeksionit respirator viral akut që për momentin është regjistruar si epidemi në qytetin Wuhan, Kinë.

Përhapja e virusit nga njeriu në njeri është e mundur, por ende nuk dihet se sa lehtë përcillet ky virusin në mesin e njerëzve. Përvojat e para tregojnë se personat e moshuar dhe personat që vuajnë nga sëmundje kronike janë të ekspozuar ndaj një rreziku më të madh nga komplikimet dhe nga format e rënda të sëmundjes.

Udhëtarëve të cilët vijnë nga Kina mund t'ju parashtrohen pyetje për gjendjen e tyre shëndetësore dhe itinerarin e udhëtimit nga ana e punonjësve shëndetësor në aeroport dhe nëse ka nevojë të ndërmerren masa të mëtutjeshme sipas procedurave paraprake e që kanë për qëllim zvogëlimin e rrezikut të importimit të infeksionit me koronavirusin.

Cilat janë simptomat e sëmundjes?

- ethe (temperaturë e lartë e trupit),
- kollë,
- vështirësi në frymëmarrje.


Sëmundja mund të shkaktojë komplikime të rënda të cilat mund ta dëmtojnë funksionin e:

- organeve të frymëmarrjes,
- sistemit kardiovaskular,
- veshkave.

Sëmundja mund të shfaqet në formë të lehtë e deri në serioze me pasojë vdekjen.

Mjekimi i të sëmurëve është simptomatik.

Nuk ka vaksinë për parandalimin e infeksioni me koronavirus.



Si të mbrojnë veten dhe të tjerët personat që udhëtojnë?

NËSE UDHËTONI PËR NË KINË OSE PËR NË VENDE KU KA EPIDEMI TË KËSAJ SËMUNDJEJE, JU DUHET TË:

Evitoni kontaktet me persona të sëmurë me infeksione respiratore;



Evitoni kontaktet me kafshë të gjalla ose të ngordhura, mos vizitoni tregje për kafshë ose produkte të kafshëve;



Mos konsumoni produkte të kafshëve të cilat nuk janë përpunuar mirë termikisht;



Lani mirë duart me ujë dhe sapun, së paku 20 sekonda;



Përdorni peceta me alkool ose me dezinficiensë, në rastet kur nuk keni mundësi të pastroheni me ujë dhe me sapun.



Çfarë duhet të bëni nëse ju shfaqen simptoma të sëmundjes?

Nëse keni qenë në Kinë, ose në vende të tjera ku ka epidemi të Koronavirusit të ri dhe nuk ndjeheni mirë, keni temperaturë të lartë të trupit, kolliteni ose keni vështirësi në frymëmarrje, ju duhet të:

- Kërkoni menjëherë ndihmë nga mjeku;
- Evitoni kontaktet me persona të tjerë;
- Të mos udhëtoni;
- Mbuloni gojën dhe hundën me faculetë për një përdorim nëse kolliteni ose teshtini. Faculetat e përdorura hidhni në koshin e plehrave;
- Mbuloni hundën edhe gojën me dorë në rastet kur nuk keni faculeta;



Personat e moshuar dhe personat që vuajnë nga sëmundje kronike që janë të ekspozuar ndaj një rreziku më të madh nga komplikimet, duhet të kenë një kujdes shumë më të madh dhe mundësisht ta anulojnë udhëtimin.